

UDC: 81

ISSN: 1857-9485 (Print)
ISSN: 2545-4919 (Online)



ALBANOLOGJIA

International Journal of Albanology



ALBANOLOGJIA | Vol. 9 | No. 17-18 | pp. 1-282 | Tetova | 2022

UDC: 81



ISSN 1857-9485 (Print)

ISSN 2545-4919 (Online)

ALBANOLOGJIA

< International Journal of Albanology >

17-18/2022

ALBANOLOGJIA | Vol. 9 | No. 17-18 | pp. 1-282 | Tetova | 2022

ALBANOLOGJIA

International Journal of Albanology

Editor-in-Chief: Vullnet Ameti

37/12

Editors: Salajdin Salihu, Berton Sulejmani, Dëfrim Saliu

Editorial Board

Albana Deda (Albania) ✓
Ali Aliu (North Macedonia) ✓
Ana Vitanova-Ringacheva (North Macedonia)
Alica Arnaut (Bosnia and Herzegovina) ✓
Arbër Çeliku (North Macedonia)
Arsim Rexhepi (Germany) ✓
Avdi Visoka (Kosovo) ✓
Belina Bedini (Albania)
Begzad Baliu (Kosovo)
Berton Sulejmani (North Macedonia)
Ellie Boyadzhieva (Bulgaria) ✓
Emine Shabani (North Macedonia)
Esilda Luku (Albania)
Etleva Lala (Hungary) ✓
Fatmir Sulejmani (North Macedonia)
Fitim Rifati (Kosovo)
Flora Koleci (Albania)
Fridrik Dulaj (Kosovo)
Ivo Fabijanić (Croatia) ✓
Ioana Albu (Romania) ✓
Izmit Durmishi (North Macedonia)
Kastriot Gjika (Albania)
Kledi Satka (Albania)
Lorena Dedja (Albania)
Lori Amy (Georgia) ✓
Mahir Mustafa (Switzerland) ✓
Majlinda Nuhiu (North Macedonia)
Marenglen Verli (Albania)
Mehmet Kraja (Kosovo)
Meral Shehabi-Veseli (North Macedonia)
Migena Alimehmeti (Albania)
Nurgül Yildiz (Turkey) ✓
Nikolina Burneva (Bulgaria)
Shaban Sinani (Albania)
Shejnaze Ajdini-Murtezi (North Macedonia)
Shezai Rrokaj (Albania)
Zemaida Mozali (Albania)

Editorial Council

Albulena Dehari (North Macedonia)
Alida Emini-Ismaili (North Macedonia)
Dëfrim Saliu (North Macedonia)
Esmije Veseli (North Macedonia)
Fatjona Abdullahi (North Macedonia)
Florim Ajdini (North Macedonia)
Hirijete Ziberi (North Macedonia)
Imer Alili (North Macedonia)
Kushtrim Ahmeti (North Macedonia)
Lindita Skenderi (North Macedonia)
Nertila Ramadani (North Macedonia)
Osman Ismaili (North Macedonia)
Remzije Nuhiu (North Macedonia)
Shadan Ramadani (North Macedonia)
Zarije Nuredini (North Macedonia)

Proofreading:

Nertila Ramadani

ISSN 1857-9485 (Print)**ISSN 2545-4919 (Online)**

Published twice a year

Account no. 160016005478810

Tax no. 4028004139891

Deponent: Narodna Banka na RM

Income Code: 723019

Programme: 43

IBAN: MK07 1007 0100 0066 227

SWIFT: NBRM MK 2X

Technical Editing / Layout

Dëfrim Saliu

Printing House:

Arbëria Design

Editorial Office: Office for Scientific
Research and Innovation, University of
Tetova

Tetova, Republic of Macedonia

Ilinden, n.n. 1200, Tetova

Phone: + 389 44 356 500

URL: www.unite.edu.mk

TABLE OF CONTENTS

SOME SYNTAX FEATURES IN MITRUSH KUTELI'S PROSE

Berton SULEJMANI..... 10

THE SONGS OF MOTMOT IN THE COLLECTION "BLETA SHQIPTARE" OF THIMI MITKO

Adelina XHAFERI..... 16

SPOKEN ALBANIAN ON PUBLIC TELEVISION OF KOSOVO AFTER THE LANGUAGE CONSULTATION OF PRISTINA AND IN THE PRESENT DAYS

Albulena ALIDEMA..... 24

CHILD-DIRECTED LANGUAGE BY YOUNG PEOPLE OR "BABY TALK"

Albulena DEHARI & Lindita SKENDERI..... 29

THEORETICAL FOUNDATIONS OF MODERN EUROPEAN THEATER

Arlind FARIZI..... 33

ISSUES OF COMPLEXITY AND RECEPTION IN THE NOVEL "GJIN BARDHELA - STONE THIRST" BY ANTON NIKA BERISHA

Arsim HALILI..... 40

THE PHENOMENON OF SENTIMENTALISM IN ALBANIAN PROSE OF THE 1930-S

Artesa OSMANAJ-MAVRAJ..... 47

TWO UNKNOWN MANUSCRIPTS IN THE FIELD OF LEXICOGRAPHY

Begzad BALIU..... 52

THE ALBANIAN LANGUAGE IN ITS FUNCTION AS AN OFFICIAL LANGUAGE

Bendis PUSTINA..... 65

LITERATURE AND WAR IN LE CLÉZIO'S *WANDERING STAR*

Dëfrim SALIU & Shejnaze AJDINI-MURTEZI & Besa SALIU..... 71

LANGUAGE AND IDENTITY IN THE OPTICS OF FOREIGNERS

Emine SHABANI..... 80

SOCIAL AND INDIVIDUAL CONTRADICTIONS IN MIGJENI'S LITERATURE

Esmije VESELI..... 85

ALBANIAN LANGUAGE AND LITERATURE IN CURRICULA IN PRE-UNIVERSITY EDUCATION IN NORTH MACEDONIA, KOSOVO AND ALBANIA

Farketa DIBRA-ZEQIRI..... 90

USE OF GAMES WHILE LEARNING GERMAN AS A FOREIGN LANGUAGE

Fatmire VEJSELI & Sahra IMERI..... 102

MEDIA HYBRIDITY AND ALBANIAN POLITICAL PARTIES IN RNM, THE RELATIONSHIP BETWEEN THEM	
Faton MURSELI & Behar MJEKIQI.....	109
LANGUAGE CONTACTS AND MIGRATION LINGUISTICS WITH A SPECIAL FOCUS ON ALBANIAN LANGUAGE IN SWITZERLAND	
Gjuliano ISEINI.....	116
PRINCE WIED – THE HOPE AND DISAPPOINTMENT OF HIS JOURNEY AS PRINCE OF THE ALBANIANS	
Hamsi BEHLULI.....	124
TRANSLATION OF PROFESSIONAL TERMINOLOGY IN TEXTBOOKS CASE STUDY: TEXTBOOKS FOR SECONDARY SCHOOLS-ECONOMIC AND JURIDICAL PROFESSION	
Hana DARDHISHTA.....	128
ALBANIAN LANGUAGE IN SCHOOL TEXTBOOKS	
Idaete SINANI.....	134
INTERTEXTUALITY IN THE NOVELS OF FATOS ARAPI	
Jehona RUSHIDI-REXHEPI.....	140
THE MENTIONING OF THE ILLYRIAN-ARBËRESH AND THEIR ILLYRIAN-ARBËRESH LANGUAGE IN SOME SOURCES	
Jeton SALLAHU.....	145
BAHRI BECI'S COMMITMENT TO THE ALBANIAN LANGUAGE	
Jonida CUNGU & Alba BALLHYSA.....	157
MEMORY, FORGETFULNESS AND THE OTHER IN THE POETRY WORK OF LINDITA AHMETI	
Kaltrina SADIKU.....	163
USE OF THE TERM „FSHAT” AGAINST „KATUND” IN KOSOVO AND THEIR SEMANTIC BACKGROUND	
Labinot KRASNIQI.....	171
MILAN JAZBECI, THIS INNOVATOR IN POETRY	
Luljeta ADILI-ÇELIKU & Meral VESELI.....	178
OVERVIEW ON THE FORM OF CONSTRUCTION OF PHRASEOLOGICAL UNITS USED IN THE SPOKEN LANGUAGE IN GJAKOVA	
Migena ARLLATI.....	183
WHERE DO BEAUTIFUL RAINBOWS DISAPPEAR? (THE DREAM, HOPE AND MEMORIES OF THE CHILD IN „THE DEER WITH ONE HORN” BY RIFAT KUKAJ)	
Marina DANILOVSKA.....	189

LINGUISTIC-STILISTIC ANALYSIS OF THE SONG „MBRAMJA” („DINNER”) BY ESAD MEKULI

Marina SPASOVSKA 193

STATUS AND CARE OF OLD SLAVIC MANUSCRIPTS AS PART OF THE CULTURAL HERITAGE IN THE ERA OF DIGITALIZATION

Mihajlo MARKOVIC & Sonja NOVOTNI 198

THE GRAMMATICAL NATURE OF THE MOMENT OD DISCOURSE, AS A POINT OF REFERENCE

Muhamet REÇICA 205

SUBORDINATE TIME CLAUSES - AN ISSUE TO BE SOLVED

Nertila RAMADANI 212

STRUGA WEDDINGS IN FOLK SONGS FROM AN ECONOMIC-ANTHROPOLOGICAL POINT OF VIEW

Rini USEINI 221

LANGUAGE PLANNING IN KOSOVO, CHALLENGES AND DILEMMAS

Sejdi GASHI 228

THE DEVELOPMENT OF EDUCATION PROCESS OF ALBANIANS IN THE PEOPLE'S REPUBLIC OF MACEDONIA IN THE 50S OF XX CENTURY

Sokol MEMETI 234

LANGUAGE ERRORS IN TRANSLATED TEXTS OF PRIMARY EDUCATION

Shejnaze AJDINI-MURTEZI & Dëfrim SALIU & Besa SALIU 242

THE THEME OF THE KOSOVO WAR IN ALBANIAN POETRY 2000 - 2010

Shkurtë KADRIU-ÇITAKU 250

EUROPEAN UNION AND THE EUROPEAN PERSPECTIVE OF WESTERN BALKANS FROM STABILITY PACT TO BERLIN PROCESS, THE CASE OF ALBANIA

Zemaida MOZALI 258

NEW TRENDS IN PICTURE BOOKS OF CHILDREN

Emine SHABANI 270

DIALECTOLOGICAL VIEWS (CONCERNING DIALECTOLOGY OF THE MACEDONIAN LANGUAGE)

Mihajlo MARKOVIC & Sonja NOVOTNI 274

ALBANIAN LANGUAGE AND LITERATURE IN CURRICULA IN PRE-
UNIVERSITY EDUCATION IN NORTH MACEDONIA, KOSOVO AND
ALBANIA

KURRIKULAT E GJUHËS SHQIPE DHE TË LETËRSISË NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR NË MAQEDONINË E VERIUT, NË KOSOVË E
NË SHQIPËRI

Farketa DIBRA-ZEQIRI¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology „Bllazhe Koneski”, University „Ss. Cyril and Methodius” in Skopje

*Corresponding author e-mail: farketadibra@gmail.com

Rrjedhat e zhvillimit të arsimit shqip në Maqedoninë e Veriut gjithmonë kanë qenë të lidhura ngushtë me rrethanat historike, shoqërore e mbi të gjitha politike. Me ndryshimet politike që ndodhën në vend pas viteve të 90-ta u ndie nevoja për një ndryshim rrënjësor në sistemin arsimor dhe strukturën shkollore në përgjithësi, për t'u përshtatur zhvillimit shoqëror, kërkesave të kohës, si dhe ngritjes së nivelit të nxënësve shqiptar, meqenëse kurrikula e deriatëhershme ishte me përmbajtje ideologjike dhe pak kishte të bënte me kërkesat e gjuhës amtare për komunitetin shqiptar.

Këto ndryshime bënë që kurrikula e gjuhës të shpëtojë sadopak nga boshti ideologjik, duke u orientuar drejt zhvillimit bashkëkohor dhe të vendoset theksi drejt aftësimin dhe zotërimin aktiv të gjuhës standarde shqipe nga ana e nxënësve shqiptar. Pas këtij dhjetëvjeçari, pason një periudhë plot e përplot me trazira, është fjala për vitin 2001 i cili la gjurmë të thella në historinë e popullit shqiptar. Kjo periudhë shënoi një kthesë të rëndësishme për një popull që nuk ka pasur të drejtën e barazisë dhe lirisë së fjalës shqipe. Me rrethanat e reja të krijuara u mundësuan intervenime dhe ripërtrirje në shumë sfera të jetës, para së gjithash në arsim, shkak i së cilës ishte edhe lufta e zhvilluar, e përqendruar kryesisht në problemin gjuhësor e në zbatimin e gjuhës shqipe në nivel zyrtar.

Gjatë kësaj periudhe kurrikula e gjuhës shqipe shënoi zhvillimin më të shpejtë e më cilësor krahasuar me të kaluarën, duke u pasuruar me: programe të reja të gjuhës shqipe, me standarde të reja vlerësimi, me standarde përmbajtjeje dhe arritjeje, njëherazi edhe me tekste të arsimit bazë për të gjitha ciklet e shkollimit. Edhe pse vazhdimisht është punuar drejt formësimit dhe ripërtërirjes së kurrikulës së gjuhës amtare për të qenë një hallkë lidhëse mes tri komponentëve: *kurrikulë - mësuës - nxënës*, shikuar nga këndvështrimi i sotëm, mund të themi se arritjet e sotme në shkollën shqipe e sidomos në lëndën e *Gjuhës shqipe dhe letërsisë* lënë për të dëshiruar.

Praktika shkollore ka dëshmuar, se përgatitja gjuhësore e nxënësve që përfundojnë shkollat e mesme në vendin tonë është mjaft e dobët. Marrë në përgjithësi, shkrimi dhe fjalori i nxënësve është i varfër dhe i gjymtë, si rrjedhojë edhe ata që përfundojnë universitetet paraqiten shumë keq në komunikimin publik ose në fushën e punës së tyre, me gojë dhe me shkrim. Për të marrë një përgjigje se ku qëndron problemi i këtyre boshllëqeve dhe vështirësive gjuhësore, duhet hedhur një vështrim drejt disa komponentëve që luajnë rol kuç e të drejtpërdrejtë në shkollimin e brezave të rinj.

Dy prej faktorëve që kushtëzojnë formim gjuhësor të nxënësit janë: *programi mësimor dhe teksti*. "Teksti shkollor është po aq i vjetër sa shkolla dhe procesi mësimor. Ai zë një vend të rëndësishëm në shkollën bashkëkohore, duke përmbushur dy funksione të rëndësishme: është burim i dijeve dhe mjet i transmetimit të këtyre dijeve te nxënësit" (Rexhepi, 2002 : 28). Si faktor i rëndësishëm ndikon fuqishëm në rezultatet e të mësuarit, sepse në të jepet jo vetëm materiali, por në një farë mase përcaktohet ecuria e procesit të të mësuarit, andaj për një pjesë bukur të madhe mësimdhënësish akoma mbetet instrumenti më i përhapur dhe padyshim me efektiv në procesin edukativo-arsimor.

Nisur nga rëndësia dhe pesha që mban mbi vete, kujtojmë se duhet treguar një kujdes i veçantë në përgatitjen, përzgjedhjen dhe botimin e teksteve për çdo cikël shkollimi. Kjo detyrë në sistemin tonë arsimor i është ngarkuar Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës në Maqedoninë e Veriut (MASH), e cila viteve të fundit është përgjegjëse për botimin dhe përdorimin e çdo teksti shkollor. Nga ana tjetër, duhet rikujtuar se gjatë viteve 1998-2010 në Maqedoninë e Veriut botoheshin shumë tekste alternative. MASH lejonte në përdorim 2-3 tekste shkollor për një lëndë mësimore, ndërsa shkollat përcaktonin se cili prej këtyre dy-tre teksteve ishte më i miri për ta. Kjo praktikë duket një periudhë e perënduar tanimë te ne.

Në sistemin tonë arsimor, për lëndën e gjuhës amtare ka vite që përdoret vetëm një tekst mësimor i përbashkët për të gjitha shkollat e vendit, i pa shoqëruar me fletore pune dhe libër mësuesi. Nisur nga këto mundësi të kufizuara që ofron Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, rreth mënyrës së përzgjedhjes dhe përdorimit të teksteve alternative, natyrshëm lind pyetjet: Çfarë cilësie kanë tekstet mësimore që përdoren në lëndën e gjuhës amtare në vendin tonë? Sa arrin t'i realizojë kërkesat e parashtruara në plan-programet mësimore?

Për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të parashtruara, hera-herës gjatë shtjellimit të kësaj teme në punimin tonë do të përipiqemi të bëjmë krahasime mes kurrikulave të të tri shteteve, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut. Krahasimet në fjalë, do të na diktojnë se në cilat segmente ka mangësi në sistemin tonë arsimor parauniversitar dhe çfarë masa duhet të ndërmarrim më tej për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë, pë t'i tejkaloar vështirësitë dhe situatat e palakmuara me të cilat përballen nxënësit dhe mësimdhënësit nga përdorimi i vetëm një teksti mësimor.

Lënda e gjuhës amtare në sistemin tonë parauniversitar përfshin sasi jo të pakta njohurish, por se sa arrin të përvetësohen këto njohuri është një çështje që varet nga shumë faktorë. Pas një vështrimi krahasues që u bëmë kurrikulave të të tri shteteve, arritëm të gjejmë pika të përbashkëta dhe dalluese ndërmjet tyre.

a) Fillimisht, vërejtëm se në sistemin arsimor të Maqedonisë së Veriut dhe të Kosovës lënda e gjuhës amtare gjithmonë ka ekzistuar e shkrirë bashkë me letërsinë në një fushë të vetme e quajtur "Gjuhë shqipe dhe letërsi". Brenda kësaj lënde është përfshirë pjesa e gjuhës shqipe dhe pjesa e letërsisë shqiptare, ballkanike dhe botërore; ndërsa kurrikula e Shqipërisë dallon nga e Kosovës dhe e Maqedonisë së Veriut së pari në ndarjen e lëndës, ku për një kohë të gjatë gjuha është mësuar e ndarë nga letërsia, ndërsa nga viti 2004 mësohet e integruar. Emërtimi i lëndës është një nga dallimet e tjera që vërehet në kurrikulën e Shqipërisë, ku lënda e Gjuhës shqipe bën pjesë në fushën "Gjuhë dhe komunikim", kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e parë e huaj dhe e dytë.

b) Sa i përket fondit të orëve që zë lënda e Gjuhës amtare, është e natyrshme që fondi i orëve të dallohet në bazë të drejtimit që mësojnë nxënësit. Në sistemin arsimor të Maqedonisë së Veriut, në drejtimet e gjimnazeve të shkencave shoqërore-gjuhësore lënda e Gjuhës amtare mësohet me 4 orë në javë, ndërsa në drejtimet profesionale katërvjeçare me 3 orë në javë. Marrë për bazë numrin e madh të orëve që zë kjo lëndë e sidomos në drejtimet e gjimnazeve ku kemi numër më të madh të nxënësve, krahasuar me shkollat profesionale, sipas një mesatare, një nxënës në arsimin parauniversitar të marrë njohuri nga lënda e Gjuhës amtare me 4 katër orë në javë, që përfshin 36 javë në vit, e në total numri i orëve vjetore arrin deri më 144 orë. Në shkollat profesionale lënda mësohet me 3 orë në javë, që në total për një vit janë të parapara 108 orë, ndërsa për katër vitet shkollore numri i orëve arrin në 432 orë. Në Shqipëri e në Kosovë gjuha amtare në drejtimet e gjimnazeve të shkencave shoqërore mësohet me 4 orë në javë, ndërsa në shkollat profesionale me 3 orë në javë. Hera-herës mund të vërehen dallime varësisht nga profili në të cilin mësojnë nxënësit, por marrë në përgjithësi fondi i orëve është pothuajse i njëjtë në të tri shtetet.

c) Një dallim që spikatet vetëm në kurrikulën e Shqipërisë është ndarja proporcionale në mes pjesës së gjuhës dhe të letërsisë, ku nga 144 orë të planifikuara për një vit mësimor, 74 orë zë pjesa e gjuhës dhe 74 orë pjesa e letërsisë shqiptare dhe botërore. Paralelisht me këtë theksohet se për jetën dhe veprën e çdo shkrimtari janë të sugjeruara 5 orë mësimore. Në kurrikulën e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut nuk kemi një ndarje proporcionale në mes pjesës së gjuhës dhe letërsisë, por në pjesën e letërsisë i lihet mundësia mësimdhënësit të mbajë llogari në ndarjen e orëve që i kushtohen jetës dhe veprës së një shkrimtari.

d) Përkitazi me këtë vërejtëm se në të tri shtetet përdoren tekste të ndryshme për po të njëjtën lëndë. Në Maqedoninë e Veriut tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, me të cilat mësojnë nxënësit e gjimnazit të reformuar, po edhe ata të shkollave profesionale (ngase nuk kemi tekste të veçanta për drejtimet profesionale), janë libra shkollorë të botuar nga shtëpia botuese Albas, për të katër vitet mësimore dhe janë në bashkautorësi të autorëve:

➤ *Gjuha shqipe dhe letërsia 1 për gjimnazet e reformuara* - Sabri Hamiti, Kujtim Shala, Xhemaludin Idrizi, Ali Aliu, Idriz Metani, Albas, 2002.

➤ *Gjuha shqipe dhe letërsia 2 për gjimnazet e reformuara* - Rita Petro, Agim Leka, Idriz Metani, Albas 2003.

➤ *Gjuha shqipe dhe letërsia 3 për gjimnazet e reformuara* - Sabri Hamiti, Ardian Marashi, Idriz Metani, Albas, 2008.

➤ *Gjuha shqipe dhe letërsia 4 për gjimnazet e reformuara* - Shaban Sinani, Ymer Çiraku, Ali Aliu, Ardian Marashi, Idriz Metani, Albas, 2004.

Tekstet në fjalë janë strukturuar në atë mënyrë që brenda një libri janë përfshirë të tri fushat: gjuha, letërsia shqipe dhe letërsia botërore, gjë që vjen në kundërshtim me tekstet që përdoren në arsimin parauniversitar të Shqipërisë dhe të Kosovës, ku për çdonjërin fushë të lëndës ka tekst të posaçëm, më saktësisht janë tri tekste për një lëndë. Mundësia e një teksti të përbashkët që përmbledh gjithë njohuritë e lëndës, siç ndodh në sistemin tonë parauniversitar e vështirëson të nxënin, meqenëse nuk janë të rralla rastet ku nxënësit frikësohen jo vetëm nga vëllimi i madh i njohurive që përmbajnë tekstet, por edhe nga trashësia e librit, aq sa nga nxënësit kemi dëgjuar ankesën “kush e mban gjithë atë libër të rëndë në çantë që ka mbi pesëqind faqe”.

Një mënyrë e ndarjes së materies së lëndës në tri tekste të veçanta siç ekziston në shtetet fqinje është hap për t’u përshëndetur dhe është një model për t’u ndjekur nga Ministria e Arsimit të Maqedonisë së Veriut, si organ që ka të drejtën legjitime në përzgjedhjen dhe lejimin e përdorimit të teksteve shkollore. Ky lëshim që ekziston në segmentin kurrikular parauniversitar në Maqedoninë e Veriut, dikton që tekstet e gjuhës amtare të mos jenë në nivelin e teksteve të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Për t'i konkretizuar idetë e mësipërme, në vazhdim të punimit në mënyrë tabelore do t'i pasqyrojmë fushat e studimit, sasinë e orëve dhe temat mësimore nga pjesa e gjuhës në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni e Veriut:

SHQIPËRI		KOSOVË		MAQEDONI E VERIUT	
kl. X, XI, XII	kl. X, XI, XII	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV
Gjuhë shqipe kl. X	Gjuhë shqipe kl. X				
<p>Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse). Morfologji 12 orë; Sintaksë 10 orë; Leksikologji 5 orë; Drejtshkrim dhe pikësim 5 orë</p> <p>Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit 40 orë Shënim. Njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen më studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse.</p>		<p>Sistemi gjuhësor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha standarde dhe gjuha e letërsisë; - Mbiemri/Ndajshtimi; - Pikësimi dhe efektet letrare; - Format e sentencave/fjalive/funksioni; - Pjesët e ligjeratës dhe fjalia (funksioni morfosintaksor); - Fjalia dhe stili; - Procesi i shkrimit; - Eseja; - Ndërrimet historike (fonetike) të tingujve të shqipes; - Trajatat e pashtjelluara të foljes; - Gjuha te letërsia e vjetër dhe te krijimtaria gojore; - Gjuha standarde dhe gjuha e folur. 		<p>Gjuhë shqipe Viti I</p> <p>Të shprehurit dhe krijimtaria 30 orë</p> <p>Tregimi 6 orë Diskutimi 7 orë Njoftimi 6 orë Përshkrimi 5 orë Njohuri të përgjithshme për gjuhën 9 orë Hartimet 8 orë Fonetikë 5 orë Morfologji 22 orë Lektyra 10 orë</p> <p>Gjithsej: 74 orë</p>	
<p>Gjuhë shqipe kl. XI</p> <p>Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse). Morfologji 12 orë; Sintaksë 10 orë; Leksikologji 4 orë; Drejtshkrim dhe pikësim 6 orë</p> <p>Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit 40 orë Shënim. Njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen më studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse.</p>		<p>Gjuhë shqipe kl. XI</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha dhe historia; - Fjalia, teksti, ligjërimi; - Koherenca e tekstit; - Fjalori abstrakt dhe afektiv; - Shqipja standarde dhe dialektet; zbatimimi i normës në të folur e në të shkruar; - Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse; - Veçoritë e funksionimit të niveleve gjuhësore; - Nga fjalia e thjeshtë tek ajo e përbërë; - Folja, marrëdhëniet sintaksore dhe vlerat modale e kohore të foljeve; - Figurat e stilit (zëvendësimi, kundërvënia, insistimi, zmadhimi zvogëlimi, analogjia); - Fjalët dhe raportet e tyre (sinonimet dhe antonimet); - Konotacionet, semantika dhe fusha leksikore); - Shkrimi letrar-lindja e projektit, Eseja; - Stilistika e bashkërenditjes dhe nënrenditjes në shqip (poezia, proza, teksti poetik). 		<p>Gjuhë shqipe Viti II</p> <p>Të shprehurit dhe krijimtaria 30 orë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjuha 40 orë -Leksikologjia 7 orë -Morfologjia 20 orë - Sintaksa 13 - Lektyra 10 orë <p>Gjithsej: 70 orë</p>	
<p>Gjuhë shqipe kl. XI</p> <p>Të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse). Morfologji 5 orë; Sintaksë 9 orë; Leksikologji 7 orë; Drejtshkrim dhe pikësim 6 orë</p> <p>Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit 35 orë Shënim. Njohuritë gramatikore, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit duhet të integrohen më studimin e teksteve përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse.</p> <p>Përgatitja e nxënësve për provimin e maturës shtetërore 6 orë</p>		<p>Gjuhë shqipe kl. XII</p> <ul style="list-style-type: none"> -Rendi leksikor, morfologjik dhe sintaksor i teksteve dhe përdorimi i gjuhës në funksione stilistike; -Njohja e veçorive gjuhësore që lidhen me paragrafin dhe tekstin si tërësi; -Gjuha e akteve zyrtare; -Artikulimi gjuhësor; - Folja dhe ligjërimi; -Stili në gjuhë dhe letërsi; -Leksikologjia dhe raportet leksikologjike të identitetit; -Mosprania e figures 		<p>Gjuhë shqipe Viti III</p> <p>Të shprehurit dhe krijimtaria 30 orë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Njohuri të përgjithshme për gjuhë 5 orë - Sintaksa 25 orë -Drejtshkrimi 5orë -Lektyra 10 orë <p>Gjithsej: 75 orë</p>	
				<p>Gjuhë shqipe Viti IV</p> <p>Të shprehurit dhe krijimtaria 30 orë (këtu janë të planifikuara edhe orë për Maturën shtetërore);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri për gjuhën 3 orë 	

		- Dialektologji 4 orë - Leksikologji 4 orë - Morfologji 8 orë - Stilistikë 15 orë - Lektyra 10 orë Gjithsej: 74 orë
--	--	---

Nga pasqyra tabelore e mësipërme, në krahun e majtë të saj na bie në sy një ndarje korrekte e njohurive gjuhësore në kurrikulën e Shqipërisë, ku njohuritë rimerren brenda tri viteve me nga 72 orë, të ndara sipas fushave: *të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse)*, që përfshin një fond prej 32 orësh dhe *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit* me një sasi prej 40 orësh. E njëjta ndarje orësh dhe fushash pason edhe në klasën XI.

Një dallim në ndarje fushash dhe rënie të numrit të orëve vërehet në klasën XII, ku fushat programore: *të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit e teksteve të ndryshme (përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, informuese-paraqitëse)*, përshijnë një mesatare prej 27 orësh; përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit zënë një fond prej 35 orësh, me qëllim që t'i lihen 6 orë përgatitjes së nxënësve për provimin e Maturës Shtetërore. Brenda këtij planifikimi, njohuritë gramatikore që mësohen, rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit janë të integruara me studimin e teksteve *përshkruese, rrëfyese, argumentuese, udhëzuese, paraqitëse*, pra ekziston një gërshetim i njohurive teorike në praktikë.

Në kurrikulën e Kosovës nuk ekziston ndarje temash në bazë të numrit të orëve, por ajo që e dallon këtë kurrikulë është planifikimi i disa temave të rëndësishme nga klasa në klasë, në të cilat shihet bashkëveprimi mes gjuhës dhe letërsisë, të cilat në kurrikulën e Maqedonisë së Veriut janë të pakta, për të mos thënë se mungojnë fare. Temat në fjalë ndikojnë në formimin gjuhësor dhe letrar të nxënësit, veçmas temat: *Format e sentencave/fjalive/funksioni; Koherenca e tekstit; Fjalori abstrakt dhe afektiv; Format e ligjërimit, gjuha argumentuese dhe ajo bindëse; Veçorit e funksionimit të niveleve gjuhësore; Stilistika e bashkërenditjes dhe nënrenditjes në shqip (poezia, proza, teksti joletrare; Rendi leksikor, morfologjik dhe sintaksor i teksteve dhe përdorimi i gjuhës në funksione stilistike*.

Në krahun e djathtë të tabelës është pasqyruar përmbajtja tematike e kurrikulës së Maqedonisë së Veriut. Një ndarje në bazë të numrit të orëve për secilën fushë të gjuhës ekziston edhe te ne, që përkon me kurrikulën e Shqipërisë, por numri i orëve të planifikuara për pjesën e gjuhës dallon në këto dy shtete. Në kurrikulën e Maqedonisë së Veriut për të katër vitet e shkollimit të mesëm pjesa e gjuhës përmbledh në vete edhe fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria*, me një fond prej 30 orësh në vit, ndërsa njohuritë gjuhësore për vitin e parë janë planifikuar të merren me 34 orë, që në tërësi formojnë shumën prej 64 orësh.

Viti i dytë parashikon vetëm njohuri gjuhësore 30 orë, që bashkë me fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria* formojnë një total prej 60 orësh. Vitin e tretë janë të parapara 35 orë vetëm nga pjesa e gjuhës dhe 30 orë nga fusha *Të shprehurit dhe krijimtaria*, që në total janë 75 orë; ndërsa në vitin e katërt planifikohen 32 orë nga pjesa e gjuhës dhe 30 orë nga fusha *Të shprehurit dhe krijimtaria*, që si tërësi formojnë një shumë prej 72 orësh.

Ajo që e veçon kurrikulën e Maqedonisë së Veriut krahasuar me atë të Shqipërisë dhe të Kosovës janë përmbajtjet tematike, sidomos në fushën *Të shprehurit dhe krijimtaria* ku synohen të punohen tema të ndryshme të lira, për të ardhur në shprehje sa puna e pavarur krijuese, aq edhe pasurimi i fjalorit dhe formimi i një stili sa më të lartë gjuhësor. Kujtojmë, se temat e përzgjedhura nga kjo fushë nuk i përgjigjen nivelit, interesimit dhe kërkesave të nxënësve, me një fjalë nuk arrin ta tërheqin vëmendjen e nxënësit për punë aktive krijuese dhe kritike.

Një mangësi, e cili nuk mund të anashkalohej është se shumë informacione jepen në mënyrë teorike, nuk ekziston një harmonizim orësh në mes teorisë dhe praktikës, si rrjedhojë shumë njohuri nxënësi duhet t'i mësojë përmes kujtesës mekanike. Pra, paraqitja e teksteve të ndryshme si përshkrues, argumentues, rrëfyes etj., që kanë për bazë aftësimin e nxënësve për të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit, siç ekziston në kurrikulën e Shqipërisë, të ne mungon. Ky konstatim flet se pjesa e gjuhës që parashihet të punohet në tekstet tona nuk e gjen zbatimin dhe vendin e duhur, pra nuk arrin të japë rezultate në formimin e duhur gjuhësor të nxënësit.

Ky punim do të ishte gjysmak nëse nuk do t'ia bashkëngjisnim të pasqyruar në mënyrë tabelore edhe pjesën e letërsisë shqiptare dhe botërore, meqenëse në sistemin tonë arsimor lënda e Gjuhës amtare gjithmonë ka ekzistuar e shkruar së bashku me letërsinë. Kuptohet, se letërsia realizohet nëpërmjet gjuhës si materie kryesore dhe jashtë saj ajo nuk mund të krijohet, të ekzistojë, të komunikojë dhe as të ndikojë estetikisht. Nga ana tjetër, letërsia përbën një material të rëndësishëm për gjuhësinë, pasi i shërben si objekt analize dhe dëshmi e shfaqjes së dukurive të ndryshme gjuhësore në periudha të ndryshme kohore.

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimin letrar, si dhe të gjinive e llojeve që lëvrohen. Përzgjedhja e veprave letrare që studiohen përgjatë tri viteve, bëhet duke respektuar një raport të drejtë mes letërsisë shqiptare dhe asaj botërore. Letërsia shqiptare do të studiohet paralelisht me letërsinë botërore, duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kuptojnë që letërsia shqiptare nuk është një njësi e veçantë dhe e ndarë, por pjesë e pasurisë letrare botërore.

Skema e pasqyruar në vazhdim të punimit përveç se na njofton me temat dhe sasinë e orëve nga pjesa e letërsisë shqipe dhe botërore, njëherazi do të na shërbejë për t'i dhënë përgjigje pyetjes se sa tekstet tona janë në shërbim të nevojave të nxënësve, që ata të aftësohen për t'u përgjigjur kërkesave për mësim bashkëkohor dhe të zhvillojnë aftësi dhe shkathtësi për të qenë të përgjegjshëm dhe vendimmarrës në çdo hap të orës mësimore.

SHQIPËRI			
Nr	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII
	Folklor Antikiteti - Shek. XVIII	Letërsia e shekullit XIX Romantizmi	Letërsia botërore e shekullit XX
1.	Cikli i kreshnikëve	Gëte - "Fausti"	Franc Kafka - "Metamorfoza"
2.	Antikiteti - Homeri "Iliada"	Hygo - "Katedralja e Parisit"	Albert Kamy - "I huaji"
3.	Eskilli "Prometeu i mbërthyer"	Bajron - "Shtegëtimet e Çajld Haroldit"	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX . Gjergj Fishta - "Lahuta e Malcis"
4.	Euripidi "Medea"	Romantizmi shqiptar De Rada - "Këngët e Milosaos"	Lasgush Poradeci - "Ylli i zemrës"
5.	Rilindja Europiane - Aligeri "Komedia hynore"	Naim Frashëri - "Lulet e verës"	Migjeni - "Novelat e qytetit të veriut" dhe "Vargjet e lira"
6.	Barleti - "Historia e Skënderbeut"	Realizmi Honore de Balzak "Xha Gorio"	Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore D. Agolli - "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo"
7.	Letërsia e vjetër shqipe- Bogdani dhe Budi - "Këngët e sibilave" dhe disa poezi të Budit	Flober - "Zonja Bovari"	Ismail Kadare - "Pallati i ëndrrave"
8.	Servantes - "Don Kishoti i Mançës"	Dostojevski - "Vëllezërit Karamazovë"	Martin Camaj - "Njeriu me vete e me të tjerët"
9.	Shekspiri - "Hamleti"	Let. e gjysmës së dytë të shekullit të XIX. Sh. Bodler - "Lulet e së keqes"	Azem Shkreli - "Lirikë me shi"
10	Klasicizmi - Molieri - "Tartufi"		
KOSOVË			
Nr	Klasa X	Klasa XI	Klasa XII
	Folklor Antikiteti - Shek. XVIII	Letërsia e shekullit XIX Romantizmi evropian	Letërsia botërore e shekullit XX
1.	Kanuni i Lekë Dukagjinit	Gëte - "Fausti"	Franc Kafka - "Procesi" apo "Kështjella"

	Këngët e Kreshnikëve; Baladat; Përrallat		
2	Klasika indo-evropiane Epi i Gilgameshit	Viktor Hygo - "Poezi"	Letërsia moderne shqiptare Konica- "Një ambasadë e Zulluve në Paris"; eseistika; Revista "Albania" L. Poradeci - "Vallja e yjeve" dhe "Ylli i zemrës" E. Koliqi- "Hija e maleve" dhe "Gjurnat e stinve" M. Kuteli- "Qysh e gjeti Ago Jakupi rugën e Zotit" dhe "E madhe është gjëma e mëkatit (Tat Tanushi). Migjeni - "Vargjet e lira"
3	Letërsia klasika greke Homeri -"Iliada"; Eskili - "Prometeu i mbëthyer"; Aristofan -"Bretkosat"; Aristoteli - "Poetika"	Bajron -"Shtegëtimet e Çajld Haroldit"	Klasika moderne
4	Klasika Latine Virgjili - "Eneida"	Letërsia e Rilindjes Kombëtare De Rada - "Këngët e Milosaos K. Kristoforidhi - "Gjahu i malësorëve" Naim Frashëri- "Lulet e verës"; "Historia e Skënderbeut"; "Bagëtia e bujqësia" S. Frashëri - "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet"	Gabriel Garsia Marques - "Njëqind vjet vetmi" E. Heminguej - "Piaku dhe deti" A. Kamy - "I huaji" L. Borhes- farnazia narrative e Borhes (Alef).
5.	Letërsia e mesjetës Këngët e Rolandit; D. Aligeri - "Ferri"; M. Servantes - "Don Kishoti"; U. Shekspiri - "Hamleti"	Realizmi Honore de Balzak "Xha Gorio"	Letërsia bashkëkohore shqipe
6.	Letërsia e vjetër shqipe Humanizmi dhe letërsia filobiblike M. Barleti- "Historia e Skënderbeut"; Gjon Buzuku- "Meshari"; Pjetër Budi - analizë e poezive; Frang Bardhi - "Apologjia e Skënderbeut"; Pjetër Bodani- "Të primt përpara letrorit"; "Krijimi i ruzullimit"; "Këngët e sibilave"; "Ligjërta".	Pararendësit e modernitetit Edgar Alan Po dhe Sharl Bodler	Martin Camaj - Ismail Kadare - "Pallati i ëndrrave" Frederik Rreshpia - cikli i poezive për nënën. Zef Pllumi- analizë e poezive Ali Podrimja - "Lum Lumi" Rahman Dedaj - analizë e poezive Azem Shkreli - analizë e poezive Anton Pashku- analizë e tregimeve dhe romanit "Oh".
7.	Letërsia arbëreshe Jul Variboba- "Gjella e Shën Mërisë Virgjër	Pararendësit e modernitetit shqiptar Gjergj Fisha - "Lahuta e Malcis" Mjeda - "Andra e jetës" F. S. Noli- "Albumi" Çajupi- elegjia "Vaje"	
8.	Letërsia e bejtexhinjve H. Z. Kamberi - analizë e poezive M. Kyçyku -"Erveheja" tema e dashurisë		
MAQEDONI E VERIUT			
Nr	VITI I	VITI II	VITI III
	Folldor Antikiteti - Shek. XVIII	Rilindja kombëtare - Romnatizmi shqiptar	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX
			Letëris shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX

1.	Eposi i kreshnikëve	J.de Rada- "Këngët e Milosaos" dhe "Këngët e Serafina Topisë" Anton Santori - "Emira" P. Vasa- "Moj shqypni e mjera Shqypni" G. Dara- "Kënga e sprasme e Balës" Zef Serembe- analize e poezive N. Frashëri- "Lulet e verës"; "Historia e Skënderbeut"; "Bagëti e bujqësi" S. Frashëri - "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet" Ndoc Nikaj - "Shkodra e rrethueme" Zef Skiroi - "Te dheu i huaj" Ndre Mjada - "Andrra e jetës" A.Z.Çajupi - "14 vjeç dhëndërr"; "Baba Tomorri" A.S.D.Asdreni -analizë e poezive nga të katër përmbledhjet me poezi.	Gjergj Fishta - "Lahuta e Malcis"; Lirikat e Fishtës; "Juda Makabe" F. Konica - "Dr. Gjilpëra"; proza e Konicës. M. Frashëri - "Hi dhe shpuzë" F.S. Noli - "Albumi"; "Israelitë e Filistinë"; "Samsoni e Dalila". Ali Asllani - "Hanko Halla" Etëhem Haxhiademi - analizë e tragjedisë "Skënderbeu" Ernest Koliqi - "Kangjelet e riëndjes"; analizë e tregimeve "Hija e maleve"; "Tregtar flamujsh"; "Pasyrat e narcizit" Mitrush Kuteli- "Vjeshta e Xheladin beut"; "E madhe është gjëmë e mëkatit (Tat Tanushi"; "Poemi kosovar" Migjeni - "Vargjet e lira" Sterjo Spase - "Pse" E. Mekuli - "Për ty"	Petro Marko - "Hasta la vista" J.Xoxa - "Lumi i vdekur" Martin Camaj - Lirikat; Proza; Korbi; Dranja Kasëm Trebeshina - "Odin Mondvalsens"; "Stina e stinëve" D. Agolli - "shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo"; Lirikat Ismail Kadare - "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" A. Pashku - "Oh"; Proza A. Shkreli - "Sytë e Evës"; Lirikat Adem Gajtani - Lirikat Ali Podrimja - "Lum Lumi"
2.	Pasqyrë për fillimet e letërsisë botërore Epi i Gilgameshit	Humanizmi dhe renesansa në letërsinë botërore D. Aligieri - "Komedia hynore" M. Servantes - "Don Kishoti i Mançes" U. Shekspir - "Hamleti"	Letërsia botërore e shek. XIX H.D. Balzak - "Xha Gorio" Gustav Flouer - "Zonja Bovari" Dostojevski - "Krim dhe ndëshkim" Sharl Bodler - "Lulet e së keqes" Leon Tolstoj - "Lufta dhe paqja"	Letërsia moderne e shek. XX Xh.Xhojsi - "Ulisi"; "Portreti i artistit djalosh" F.G.Lorka - "Romancero cigjan" Franc Kafka - "Procesi"; "Metamorfoza" A. Kamy - "I huaji" E. Heminguej - "Plaku dhe deti" J.L.Borges - tregime G.G. Markes - "Njëqind vjet vetmi"
3.	Letërsia klasike greke Homeri - "Iliada" Safo- poezi Eskili - "Prometeu i mbëthyer" Aristofan - "Bretkosat"	Klasicizmit botëror Molieri - "Tartufi" Zh. Rasini - "Andromaka"		
4.	Letërsia klasike romake Virgjili - "Eneida"	Letërsia e romantizmit evropian Gëte - "Fausti" Bajron - "Shtegëtimet e Çajld Haroldit" Aleksandër Pushkini - "Eugjen Onjegini" V. Hygo - "Të njerët"		
5.	Letërsia e vjetër shqipe Humanizmi shqiptar Marin Barleti- "Historia e Skënderbeut"			
6.	Letërsia filobiblike Gj.Buzuku - "Meshari" Pjetër Budi- analizë e poezive Pjetër Bogdani - "Çeta e profetëve" F. Bardhi - "Apologjia mbi Skënderbeun" dhe Fjalori latinisht-shqip			
7.	Letërsia arbëreshe Jul Variboba - "Gjella e Shën Mërisë Virgjër"			
8.	Letërsia e Bejtexhinjve H.Z. Kamberi - "Paraja" dhe "Gjerdeku i vashës" M. Kycyku - "Erveheja"			

Pas analizave dhe krahasimeve që realizuam me kurrikulat e të tri shteteve erdhëm në një pikë ku mund të konstatojmë mangësi dhe lëshime në kurrikulë dhe tekstet mësimore. Parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, mund të themi se tekstet tona nuk arrijnë ta ndihmojnë nxënësin drejt aftësisimit dhe zotërimit të normës standarde, edhe pse teksti shkollor mendohet si një nga burimet kryesore të njohurive për formimin e shprehive praktike, duke paraqitur një lidhje midis komponentëve të ndryshëm të çdo mësimi. Përgjithësisht, mendohet se tekstet që përdoren në arsimin parauniversitar në vend u përgjigjen kërkesave të kurrikulës, por realiteti dëshmon se nuk po arrihet të realizohen synimet.

Këtë gjendje së pari mund ta dëshmojmë duke krahasuar ndarjen e orëve në kurrikulë me sasinë e materialit që jepet në tekst për t'u punuar. Nga ky krahasim rezulton, se një mësimdhënës me përvojë do ta ketë të vështirë të bëjë një ndarje të duhur në mes pjesëve që duhet punuar, e jo më një mësimdhënës i ri, i cili s'do mend se do të humbet në faqet e panumërta që flasin mbi jetën dhe veprimtarinë e një autori.

Përmbajtja e njohurive të shumta, përsëritja e tyre dhe mbingarkesa e informacionit i karakterizon tekstet tona. Kjo mbingarkesë ndikon negativisht në baraspeshën teori-praktikë, njohuri-aftësi si dhe vendosja e peshës në memorien mekanike të nxënësve, të cilët duhet të riprodhojnë njohuri si qëllim në vete. Pra, edhe pse ka mbingarkesë konceptesh në tekste mësimore, disa fare të reja për nxënësit, janë pengesë që nxënësit të konstatojnë, të analizojnë, të rikujtojnë, të riprodhojnë dhe të gjykojnë për faktin gjuhësor mbi një material të gjallë e të gjerë gjuhësor, por thjesht vetëm të memorizojnë.

Niveli gjuhësor që përdoret në këto tekste hera-herës, mund të themi se i përgjigjet nivelit akademik, por jo edhe nivelit të nxënësve, meqë në to gjejmë fjalë tepër të thata e abstrakte, jo të kuptueshme dhe konfuze, që janë të vështira për t'u përvetësuar nga nxënësit e sidomos nga ata që vinë nga pjesët rurale të vendit, të cilët përbëjnë shumicën. Siç dihet, shpjegimi i saktë, i qartë i termave gjuhësore, letrare e kulturore, ndikon drejtpërdrejt jo vetëm në formimin gjuhësor të nxënësve, por edhe në përvetësimin e saktë të dijeve, por kur ky nivel gjuhësor ndërlikohet në tekstet shkollore, atëherë ndërlikohen edhe problemet gjuhësore, ato bëhen të paqarta e të pakuptueshme për nxënësit. Kjo i bën ata që në të shpeshtën e rasteve kur duhet ta dinë ndonjë frazë apo ndonjë pjesë të mësimi, atë e mësojnë jo përmes kujtesës logjike, por në mënyrë mekanike.

Sa i përket aparaturës didaktike dhe metodike, në këtë kontekst mund të themi se teksti shkollor duhet të përmbajë një aparaturë didaktike në përputhje me kërkesat bashkëkohore për të nxënësit aktiv dhe kreativ. Tekstet tona kanë një aparaturë të varfër, mungojnë rubrika të veçanta, që me plotësimin e kërkesave të tyre do të sjellin një përmirësim të ndjeshëm në njohjen dhe ngulitjen e rregullave gramatikore. Tekstet nuk duhet të japin vetëm njohuri teorike, për atë se çfarë është gjuha standarde, dialektet dhe gramatika e saj, por duhet të synojë që nxënësit të aftësohen jo vetëm që ta përdorin gjuhën standarde, por më tepër se kaq, *gjuhën shqipe në përdorim në situata të larmishme të foluri* për t'u bërë qytetarë që zotërojnë gjuhën aplikative, atë që u duhet për t'u aftësuar për jetën në të gjitha fushat dhe terminologjinë e tyre.

Nga sa u tha më lart, mund të përfundojmë, se as tekstet shkollore e as kurrikula në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk janë të dëshiruara, mendojmë se është koha për t'i rishikuar e përmirësuar ose për t'i hapur rrugë hartimit të kurrikulave dhe teksteve të reja, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e nivelit gjuhësor e njohurive letrare. Mes tjerash, konstatojmë se: në shtetin tonë parauniversitar mungon përgatitja solide pedagogjike; nuk përdoren metoda e strategji bashkëkohore, që të nxisin mendimin kreativ e kritik dhe të rrisin cilësinë dhe efikasitetin e mësimi; mësimdhënësit e lëndëve të tjera pak bëjnë përpjekje që përmes lëndës së tyre të ndikojnë në zhvillimin gjuhësor të nxënësve; ndikimi i gjuhëve të huaja, veçmas i maqedonishtes si gjuhë e parë ose zyrtare në Maqedoninë e Veriut ka ndikuar në masë të madhe në tërë strukturën e gjuhës shqipe.

Që të përmirësohet sadopak kjo situatë e pamirë dhe të ngritet kultura gjuhësore e nxënësve, si dhe e gjithë përdoruesve të shqipes standarde në Maqedoninë e Veriut, ia dolëm të hartojmë disa rekomandime:

- të formohet një qendër për arsimin kombëtar shqiptar në Shqipëri, e cila do të ketë në mbykqyrje të gjitha kurrikulat dhe tekstet shkollore të gjuhës dhe letërsisë shqipe, në këtë mënyrë do të bëhet harmonizimi i kurrikulave dhe i teksteve shkollore për Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe diasporë.
- të harmonizohet sasia e orëve për lëndën e gjuhës amtare në të tri shtetet, në të gjitha profilet e arsimit parauniversitar, që niveli i njohjes së gjuhës standarde të jetë i njëjtë.
- që të kemi një integrim kombëtar rekomandojmë që të hartohen tekste mësimore të unifikuara për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe për gjithë Ballkanin.
- në të gjitha universitetet e Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, lënda e Kulturës së gjuhës të jetë e domosdoshme për të gjitha profilet.
- të mbahen takime ndërmjet mësimitdhënësve dhe prindërve për të bashkërenditur punët, si dhe për të marrë e dhënë këshilla e propozime.
- përpilimi i teksteve të bëhet nga një ekip specialistësh, akademikësh, mësues të shkollave të mesme etj.
- të hartohet një udhëzues praktik kombëtar për shtëpitë botuese dhe autorët e teksteve shkollore të Gjuhës e të letërsisë, për zbatimin e standardeve të teksteve shkollore.

Realizimi i rekomandimeve të lartpërmendura, natyrisht se do të ndikojë në përmirësimin e kësaj situate të kulturës së dobët gjuhësore dhe do të ngrejë mjaft nivelin e nxënësve në zotërimin e shqipes standarde. Në këtë vazhdë nuk duhet neglizhuar edhe fakti, se ka ardhur koha që përpos rishikimeve dhe përmirësimeve të lartpërmendura, njëherazi duhet kushtuar kujdes edhe përgatitjes së mësuesve për një punë më të mirë të orientuar, sepse sado i mirë të jenë tekstet, sado e pasur të jetë baza materiale- teknike, të gjitha këto kthehen në lodra pa vlerë, po qe se mësuesi si organizator e udhëheqës, nuk ka formimin e duhur shkencor e metodik, për ta shndërruar në mjet të dobishëm mësimor.

Referencat

- [1]. Hamiti, Sabri & Shala, Kujtim & Idrizi, Xhemaludin & Aliu, Ali & Metani, Idriz: *Gjuha shqipe dhe letërsia 1 për gjimnazet e reformuara*, Tetovë, 2002.
- [2]. Hamiti, Sabri & Marashi, Ardian & Metani, Idriz: *Gjuha shqipe dhe letërsia 3 për gjimnazet e reformuara*, 2008.
- [3]. MASH, Programi për gjimnazin e reformuar arsimor, *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti I*, Shkup, 2001.
- [4]. MASH, Programi për gjimnazin e reformuar arsimor, *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti II*, Shkup, 2002.
- [5]. MASH, Programi për gjimnazin e reformuar arsimor, *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti III*, Shkup, 2003.
- [6]. MASH, Programi për gjimnazin e reformuar arsimor, *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti IV*, Shkup, 2004.
- [7]. MASH, Programi mësimor *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti I (shkolla e mesme profesionale)*, Shkup, 2006.
- [8]. MASH, Programi mësimor *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti II (shkolla e mesme profesionale)*, Shkup.
- [9]. MASH, Programi mësimor *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti III (shkolla e mesme profesionale)*, Shkup, 2008.
- [10]. MASH, Programi mësimor *Gjuhë shqipe dhe letërsi, viti IV (shkolla e mesme profesionale)*, Shkup, 2008.
- [11]. Petro, Rita & Leka, Agim & Metani, Idriz: *Gjuha shqipe dhe letërsia 2 për gjimnazet e reformuara*, Tetovë, 2003.
- [12]. Rexhepi, Nuhi: *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Prishtinë, 2002.
- [13]. Sinani, Shaban & Çiraku, Ymer & Aliu, Ali & Marashi, Ardian & Metani, Idriz: *Gjuha shqipe dhe letërsia 4 për gjimnazet e reformuara*, Tetovë, 2004.
- [14]. Tafani, Vilma: *Probleme psiko- didaktike të të shkruarit në gjuhën Angleze në mjedisin shkollor shqiptar*, Tiranë, 2010.

Referenca nga interneti

- [1]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/01/Gjuh%C3%AB-shqipe-3.pdf> marrë më 15.06.2019.
- [2]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/01/Gjuh%C3%AB-shqipe-2.pdf> marrë më 15.06.2019.
- [3]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-KL-X-XI.pdf> marrë më 18.06.2019.
- [4]. <https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar> marrë më 18.06.2019.
- [5]. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-3-final.pdf> marrë më 18.06.2019.
- [6]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-X.pdf> marrë më 18.06.2019.
- [7]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/LETESI-X.pdf> marrë më 18.06.2019.
- [8]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-KL-X-XI.pdf> marrë më 18.06.2019.
- [9]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Letersi-5.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [10]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Gjuh%C3%AB-shqipe-1.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [11]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Letersi-3.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [12]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/GJUHE-SHQIPE-klasa-10-dhe-11.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [13]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Letersi-Klasa-X-XI.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [14]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Gjuhe-Shqipe-Klasa-X-XI.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [15]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Letersi-Klasa-X-XI.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [16]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Gjuhe-shqipe-XII-XIII.pdf> marrë më 20.06.2019.
- [17]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Letersi-XII-XIII.pdf> marrë më 28.06.2019.
- [18]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/05/Gjuhe-shqipe-XII-XIII.pdf> marrë më 28.06.2019.
- [19]. <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/05/Letersi-XII-XIII.pdf> marrë më 28.06.2019.
- [20]. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/11/Doktoratura-Edlira-Xega-Fakulteti-i-Gjuheve-te-Huaja-Departamenti-i-Gjuhes-Angleze1.pdf> marrë më 11.05.2019.

